



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
KUVENDI I KOMUNËS / SKUPSTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec
RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/13 Nr. i faq./Br.str./No.pg 75

Data/Datum/Date 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Ligji Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-62 për Fshatin Hoçë e Madhe ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2012"), Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 11/2014 për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e Këshillit për Fshatin Hoçë e Madhe, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.01.2025 miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e planit të punës të Këshillit për Fshatin Hoçë e Madhe Janar-Dhjetor 2025

1. Me këtë vendim **miratohet** axhenda dhe plani i punës i Këshillit për Fshatin Hoçë e Madhe Janar-Dhjetor 2025.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është plani i punës i Këshillit për Fshatin Hoçë e Madhe Janar-Dhjetor 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Këshilli për Fshatin Hoçë e Madhe.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 01 Nr. 279/24 i datës 26.12.2024.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Këshillit për Fshatin Hoçë e Madhe,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.13/25
Datë:31.01.2025

